



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-30920/17
Kaçanik, 15.09.2017

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VIII (Tetë)** e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik (Legjislatura e V-të), mbajtur më datë 15 Shtator 2017. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarët, pjesëmarrës në mbledhje ishin 27 anëtarë- të gjithë anëtarët.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës –Remzi Elezi, drejtorë të drejtorive komunale – (Bahri Selimi, Enver Kamishi, Diana Reka, Zylfi Koxha dhe Ramadush Osmani).

Nga Mbledhje morën pjesë edhe zyrtarët: Fatlume Guri- zyrtare për informim.

Nga OSBE- mbledhja u monitorua 2 zyrtarë.

Mbledhjen e kryesoj, Xhelal Gashi, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës, Makfire Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Xhelal Gashi, Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, kuorumi ekziston me u mbajtur mbledhja, kushte pune ka, andaj e hapi mbledhjen e VIII (Tetë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2017, data; 15 Shtator, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Projekt Propozimi i Buxhetit të Komunës, për vitin fiskal 2018 dhe Vlerësimet për vitet 2019-2020;
3. Propozim Rregullorja për vendosjen e tatimit në pronë, në territorin e komunës së Kaçanikut, për vitin 2018;
4. Propozim Rregullorja për ndryshim plotësimin e Rregullores për pagesën e tarifave, ngarkesave administrative, gjobave dhe shërbimeve të tjera komunale 01Nr. 16-4838/16 e datës 15.02.2016;
5. Propozim Vendimi për ndarjen e masës drusore, shkollave të komunës.

Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë, Rendin e propozuar të punës e shtroj në votim për aprovim. Rezultati i votimit ishte njëzëri Për këtë Rend Pune. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës , e

APROVOJ

Rendin e Punës në Përbërje 5 pikave.

Kryesuesi i Kuvendit, Konstatoj me kalua në shqyrtimin e pikëve sipas radhës;

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të Kuvendit të Komunës aprovua njëzëri me vërejtjen e znj. Nazife Krasniqi, ashtu që të Kërkesa e saj, duhet të qëndroj konstatimi së fjala ka qenë për zgjerimin e rrugës” Avdyrrahim Shehu”, e jo siç është shënuar në proces.

Në sajë të kësaj del konstatimi së, Kuvendi i Komunës e,

APROVOJ,

Procesverbalin e mbledhjes së VII (Shtatë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 28 Korrik 2017 / Lënda: 01Nr. 104/02-23855/2017.

2. Projekt Propozimi i Buxhetit të Komunës, për vitin fiskal 2018 dhe Vlerësimet për vitet 2019-2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Për sqarime të nevojshme në këtë dokument, fjalën ia jap drejtorit të DEFZH, Bahri Selimi.

z. Bahri Selimi, Theksoj së Buxheti i projektuar nuk pëson ndryshime nga ajo që është përcaktuar në Qarkoren Buxhetore, në shumë: 7.563.220.00€.

Granti Qeveritar është 90.42 %, apo në shumë : 6,838,559.00€, ndërkaq të HVK janë 9.19%, apo 694,915.00€. Në buxhetin e vitit 2018 është futur edhe Huamarrja, e cila është 0.39% në shëndetësi dhe në arsim e përbërjes së buxhetit. Krahasimet: Granti qeveritar ka shënuar rritje për 10.69%, të HVK kanë shënuar ulje për 19.29% në zvogëlim të projeksioneve për dallim nga buxheti i vitit 2017. Në total, buxheti i vitit 2018, shënon një rritje për 7.44% nga buxheti 2017, apo për 523,938.00€ që i vjen diku mbi gjysmë milioni euro

Ngritja e buxhetit është shpërndarë kryesisht për Investime Kapitale dhe për Mallra e Shërbime. Të projektet kapitale janë listuar ajanë 60 projekte të cilat mendojmë t'i realizojmë për gjatë tri vjetëve. Në vazhdim drejtori i financave i përmendi të HVK të planifikuar, shpenzimet buxhetore sipas sektorëve dhe sqarime tjera të nevojshme që kanë të bëjnë me buxhetin 2018 dhe projektimet për vitet 2019-2020.

Kryesuesi i Kuvendit, I dëgjua sqarimet e drejtorit në Projekt Propozimi i Buxhetit të Komunës, për vitin fiskal 2018 dhe Vlerësimet për vitet 2019-2020; nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Artan Shehu, Në f. 8 të materialit kam disa vërejtje teknike, Nëse e shikojmë në total numrin total buxhetin të pagat dhe mëditjet të struktura gjinore, nuk ta jep numrin e përcaktuar që është shënuar në materialin e buxhetit.

Të Investimet kapitale, janë listuar shumë projektet, ndërkaq duhet të definohet fjala rregullim dhe fjala ndërtim, sepse ndërtim është me ndërtuar një diçka që nuk ekziston.

Të Investimet kapitale, të Zonat Industriale, për gjatë fushatës Kryetari i Komunës ka premtuar se do të investohet në zonat industriale, por kjo nuk është bërë. Në këtë kuptim mendoj se investimet e propozuara në zonat industriale janë bërë dhe po bëhen sa për fushatë.

Tjetër, rregullimi i rrugëve lokale, kërkoi më shumë sqarime dhe detaje rreth financimit të projekteve kapitale se cilat nga rrugët do të rregullohen, sepse mos specifikimi i tyre të bënë më dyshuar se është duke u bërë për fushatë.

Të ndërtimi i shkollave të mesme profesionale, këtu është gabuar ose në tekst, sepse komuna e Kaçanikut e ka vetëm një shkollë të mesme profesionale.

Të Arsimit, çështja e udhëtimit të nxënësve, dihet se janë paguar shpenzimet e udhëtimit nga subvencionet dhe transfere, mirëpo nuk është menduar se në çfarë kushtesh udhëtojnë nxënësit, a kanë vend ku me qëndruar për mos me i lagur shiu, a kanë ulëse në autobus, etj.

Nëse një vend-stacion ta llogarisim së kushton 4000 € me u rregulluar, nuk është shumë sepse ai objekt do të shfrytëzohet edhe për qytetarët tjerë.

Çështja e Ujit të pijes në Kaçanik, dihet problemet që i ka rrjeti i ujësjellësit në qytetin e Kaçanikut, kërkoj të investohet në këtë rrjet.

Me intereson të di se cili nga projektet kapitale ofron mundësi për punësim, kur dihet fakti se sot është problem për me ardhur deri të punësimi i të rinjtë të komunës sonë.

Të HVK, në mbledhjen e kaluar, drejtori na paraqiti Raportin për të HVK, ndërkaq ne nuk u pajtuam me raportin e prezantuar sa i përket pronës komunale, sepse një pjesë e të HVK janë nga ndërtimi i autostradës dhe një pjesë nga inkasomi për faljen e borgjeve.

z. Bahri Selimi, Ne jemi duke debatuar për planifikimin e buxhetit të komunës për vitin 2018 dhe projeksionet për vitet 2019-2020 e jo për realizimin e të HVK. Pyetjet mund të bëhen për planifikimin buxhetor dhe orientimet e buxhetit.

Të pyetja se cili projekt ofron mundësi për punësim, kjo është ndërtimi i shkollave të mesme profesionale. Këto janë projekte të cilat i mendon komuna, e jo me u ndalur vetëm me një shkollë profesionale.

Të gabimet teknike, mund të ketë ndonjë gabim, do shikoj materialin dhe do t'i përmirësoj.

Të Zonat Industriale, përgjegjës me investuar është MTI e jo komuna, komuna investon me një pjesë të mjeteve e jo 100%, ndërkaq një problem që na ka përcjellë me Zonat Industriale janë kontesteve pronësor-juridike.

z. Kemal Mërseli, Buxheti i Komunës për vitin 2018 është ky që është, ndërkaq dihet së Kërkesat e qytetarëve janë të mëdha me çka është e pamundur të plotësohen të gjitha nevojat e tyre me këtë buxhet që ka komuna e jonë. Unë e vlerësoi rritjen e buxhetit për gjysmë milioni për vitin 2018, e cila rritje do të orientohet kryesisht tek investimet kapitale që prekin direkt qytetarin e komunës.

Një pjesë e buxhetit të komunës dihet se shkon për investime kapitale. Të çështja e Investimeve Kapitale, dihet se nuk është investuar deri me tani asnjë euro në Zonat Industriale, e që tani është duke u realizuar rrjeti i Kanalizimit dhe ai i Ujësjellësit në Zonën Industriale në Doganaj, me çka kujtoj së ky investim është edhe në interes të qytetarëve të komunës. Zonat Industriale janë në obligim të ministrisë së Infrastrukturës për me investuar, ndërkaq komuna investon me një pjesë të mjeteve buxhetore.

z. Artan Shehu, Nëse analizojmë buxhetin e vitit 2017 me buxhetin e propozuar të vitit 2018, shihet së me buxhetin e vitit 2018, HVK shënojnë ulje.

Të shkollat profesionale që e potencova çështjen e ndërtimit të tyre, dihet sa kushton një shkollë duke u nisur nga Ndërtimi i shkollës fillore në lagjen “Dushkajë” ndërkaq komuna shihet se me buxhet ka planifikuar pak mjete për ndërtimin e shkollës profesionale, ndërkaq komuna e Kaçanikut dihet se e ka vetëm një shkollë të mesme profesionale.

Të Zonat Industriale, mirë që po investohet në infrastrukturën e ujësjellësit dhe kanalizimit të këtyre zonave, ndërkaq në zonat tjera industriale, ende nuk është bërë ndonjë investim.

Të çështja e Ujit të pijes, unë fola për ujësjellësin e qytetit të Kaçanikut, i cili është ndërtuar që shumë vjet dhe dihet se me çfarë gypash është i ndërtuar.

z. Shukri Luta, Ajo që është punuar deri me sot është parë, ndërkaq jemi duke shqyrtuar buxhetin për tri vitet vijuese, i cili buxhet për Investime Kapitale shihet se ka shënuar një ngritje, kjo nuk është keq, ndërkaq nevojat e qytetarëve të komunës janë të mëdha.

Pasi jemi gati në kohë fushate, dihet se përplasja me e madhe kryesisht bëhet për buxhet. Në Listën e prioriteteve shihet se kanë hyrë disa projektet kapitale, por ajo që me shqetëson mua është, çdo projekt i cili realizohet të bëhet mirë të jetë i qëndrueshëm, e jo të ribëhet si ka ndodhë me disa projekte tjera, kjo është në përgjegjësi të komunës. Ky buxhet është ky që është, ndërkaq mundësia me bërë projekte të mira ka komuna e Kaçanikut, në mënyrë që me përfutur donacione për projektet e caktuara. Mjetet e parapara për investime kapitale nuk janë pak, por duhet të bëhen projektet mirë e jo si rruga “Ismajl Raka” apo ndonjë projekt tjetër që duhet intervenohet përsëri. Unë në këtë rast do të abstenoj në çështjen e buxhetit, ndërkaq vlerësimet e mia janë se për të gjitha mandatet sa kam qenë anëtarë i KK, ky Kuvend është me i dobëti deri me tani, shpresoj për një Kuvend me aktiv pas këtij kuvendi, ndërkaq kërkoj ndjesë nëse e kam lënduar dike për gjatë këtij mandati. Dihet se Kuvendi i ri nuk do të jetë me këtë përbërje, sepse disa nuk kanë kandiduar për me marrë edhe një mandat, ndërkaq edhe ata që janë kandiduar nuk i dihet a e marrin mandatin. Kjo është një garë e subjekteve politike dhe secili që është kandiduar dhe mund të kërkojmë nga sot votën e qytetarit të komunës.

znj. Nazife Krasniqi, Të buxheti gjinor, e bëra një krahasim të pagave të buxhetit me strukturën e kundërt dhe ky buxhet është i vogël. Shpresoj në të ardhmen buxheti gjinor të ketë përfshirje me të madhe të femrave apo të përafrohet me buxhetin e meshkujve.

Kryesuesi i Kuvendit, Meqë nuk ka diskutime të tjera, atëherë Projekt Propozimi i Buxhetit të Komunës, për vitin fiskal 2018 dhe Vlerësimet për vitet 2019-2020; shtrij në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër votë nuk pati, Abstenuan 8. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Aprovimin e Projekt Propozimi i Buxhetit të Komunës, për vitin fiskal 2018 dhe Vlerësimet për vitet 2019-2020/ Lënda 01Nr. 400/01-29953/17.

3. Propozim Rregullorja për vendosjen e tatimit në pronë, në territorin e komunës së Kaçanikut, për vitin 2018;

Për këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit e hapi diskutimin, por nuk u paraqit kush, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë :

VENDIM

Me të cilin e Apropoj Rregulloren për vendosjen e tatimit në pronë, në territorin e komunës së Kaçanikut, për vitin 2018 / Lënda 01Nr. 104/02-30543/17.

4. Propozim Rregullorja për ndryshim plotësimin e Rregullore për pagesën e tarifave, ngarkesave administrative, gjobave dhe shërbimeve të tjera komunale 01Nr. 16-4838/16 e datës 15.02.2016;

Edhe për këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit e hapi diskutimin, por nuk u paraqit kush, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë :

VENDIM

Me të cilën Apropohet Rregullorja për ndryshim plotësimin e Rregullore për pagesën e tarifave, ngarkesave administrative, gjobave dhe shërbimeve të tjera komunale 01Nr. 16-4838/16 e datës 15.02.2016.

5. Propozim Vendimi për ndarjen e masës drusore, shkollave të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit, Një Vendim i tillë është mbështetur sa herë nga Kuvendi i Komunës, edhe pse dihet se nuk i mbulon të gjitha nevojat. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Artan Shehu, Ndarja e druve të konfiskuara është vendim i qëlluar, mirëpo në aspektin ligjor, kujtoj se nuk është sa duhet në rregull.

z. Kemal Mërseli, Ne subjekti politik i PDK do ta përkrahim këtë Propozim Vendim, ndërkaq kam një Kërkesë që t'iu lejohet qytetarëve të komunës me marrë dru në malet e komunës tonë, me pagesën e taksës qysh është aplikuar deri me tani, sepse nevojat e qytetarëve për lëndë djegëse-dru janë të mëdha.

z. Shukri Luta, A ka mundësi që drutë e konfiskuara të jenë në një vend të përcaktuar, në mënyrë që me ditur sasinë e tyre.

Kryesuesi i Kuvendit, Sa i përket ligjshmërisë së vendimit për ndarjen e masës drusore shkollave, pajtohem me mendimin e z. Artan Shehu, mirëpo një vendim të tillë e kemi marrë çdo vit, dhe nuk na është kontestuar aspekti i ligjshmërisë nga MAPL.

Meqë nuk ka kush ndonjë diskutim tjetër, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për ndarjen e masës drusore të konfiskuar, shkollave të komunës/ Lënda 91Nr. 08-322/01-28982/17.

Pas përfundimit të pikëve sipas rendit të punës, Kryesuesi i Kuvendit e njoftoj Kuvendit se kemi planifikuar të mbajmë edhe një mbledhje të Kuvendit për datë 21 Shtator 2017.

Për shkak të Fushatës zgjedhore, nuk kemi mundësi të mbajmë mbledhje pas datës 21 Shtator, kështu mbetet në kompetenca të juaja të vendosni se a jeni që mbledhja e 9 e Rregullt e Kuvendit të Komunës të mbahet për datën 21 Shtator 2017.

Për shkak të disa angazhimeve të tjera që kishin disa nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, propozuan që mbledhja e 9 e Rregullt e Kuvendit të Komunës të mbahet me datë 20 Shtator 2017, ashtu edhe u vendos.

Mbledhja e 9-të e Rregullt e Kuvendit të Komunës u caktua për datën 20 Shtator 2017, në ora 11:00.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu Kryesuesi i Kuvendit në ora: 11:43 e konstatoj mbledhjen të përfunduar.

Procesmbajtës
Makfije Malsiu



Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-30920/17
Kaçanik, 15.09.2017

DREJTORISË PËR FINANCA, EKONOMI DHE ZHVILLIM,
-këtu-

Lënda: U dërgojmë Regjistrin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, nga mbledhja e VIII (Tetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 15 Shtator 2017.

Bashkangjitur me këtë shkresë u dërgojmë, Regjistrin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës nga mbledhja e VIII (Tetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 15 Shtator 2017.

Nga përbërja e përgjithshme prej 27 anëtarëve sa ka Kuvendi i Komunës, në këtë mbledhje kanë marrë pjesë 27 anëtarë.

Për kompensim për pjesëmarrje në mbledhje janë gjithsej 26 anëtarë, sepse Kryesuesi i Kuvendit nuk kompensohet për pjesëmarrje në mbledhje.

Regjistrin u dërgojmë me qëllim që t'i ndërmerri veprimet e nevojshme për kompensim, në pajtim me Udhëzime të Qeverisë së Republikës së Kosovës që janë në fuqi dhe në pajtim me Vendimin e Kuvendit të Komunës për kompensim e stafit politik.









Shkresa për dorëzim të regjistrit, përmban numrin e Ftesës për mbledhje:
01Nr. 60/01-30920/17.

Shtojcë: Regjistrin me 26 nënshkrime



REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës, 03 Nëntorit 2013)

Evidenca për pjesëmarrjen e Anëtarëve të Kuvendit të Komunës, në mbledhjen e VII I (Tetë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës, mbajtur më datë, 15 Shtator 2017

1	2	3	5
Nr. Rend.	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Nënshkrimi
01.	Bajram Baftiri	Anëtar	
02.	Ramadan Dema	"	
03.	Osman Krasniqi	"	
04.	Sabedin Vishi	"	
05.	Kemal Mërseli	"	
06.	Nexhat Loku	"	
07.	Arbesa Berisha	"	
08.	Pranverë Loku-Zharku	"	
09.	Arbnora Kuka	"	
10.	Fitore Luzha	"	
11.	Hajdar Loku	"	
12.	Kadri Krivenjeva	"	
13.	Lirije Qeli-Luta	"	
14.	Tahir Çaka	"	
15.	Sherife Troni	"	
16.	Selim Reka	"	
17.	Artan Shehu	"	
18.	Nazife Krasniqi	"	
19.	Lejla Koxha-Shehu	"	
20.	Basri Kodra	"	
21.	Raif Kasa	"	
22.	Vlora Dema	"	
23.	Avni Tafili	"	
24.	Lebibe Bela	"	
25.	Shukri Luta	"	
26.	Samira Burrniku	"	

Vërtetohet, Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E KACANIKUT OPSTINA KACANIK		
Data	21. 09 /17	Vendi
Nj. org.	Nazari	Shtojce
01 Nr. 60/01-30920 /17		

PËR: Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal,
-Zyrës Ligjore-

NGA: Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Kaçanik, Xhelal Gashi

Lënda: Dërgimi i Vendimeve të mbledhjes së VIII(Tetë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, mbajtur me 15 Shtator 2017.

Bashkëlidhur me këtë Shkresë, u dërgojmë, Vendimet e Kuvendit të Komunës Kaçanik, nga mbledhja e VIII (Tetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë : 15 Shtator 2017, dhe atë:

1. Vendimi për buxhetin e komunës për vitin fiskal 2017 / Lënda 01Nr. 400/01-29953/17;
2. Vendimi për Aprovimin e Rregullores për vendosjen e tatimit në pronë në territorin e komunës së Kaçanikut për vitin 2018 + Rregullorja / Lënda: 01Nr. 104/02-30543/17;
3. Rregullorja për ndryshim plotësimin e Rregullores për pagesën e tarifave, ngarkesave administrative, gjobave dhe shërbimeve të tjera komunale 01Nr. 4838/2016 të datës 15.02.2016 / Lënda 01Nr. 104/02-30629/2017;
4. Vendimi për ndarjen e masës drusore të konfiskuar-shkollave / Lënda: 01Nr. 08-322/01-28982/17.

Vendimet ua dërgojmë në afatin e përcaktuar ligjor, me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së tyre nga Zyra Ligjore e MAPL-së.

Me respekt!



Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi